



2013

RAPORT- TM₂ -2013



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000


www.hr-jugor.com

PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësish të K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	4
I. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	5
1.1 Aktivitetet – Prill-Qershor 2013	5
1.2 Aktivitetet e Shërbimit Teknik për eliminimin e humbjeve teknike	8
1.3 Planifikimi I investimeve emergjente	8
1.4 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	9
1.5 Zyra për planifikim dhe zhvillim	9
1.6 Servisimi I ujëmatësave	13
1.7 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	15
1.8 Raport I performancave operative- Tm_1 - Tm_2	17
II. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	20
2.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	20
2.2 Pengesat në realizimin e objektivave	21
2.3 Planet për të ardhmen	21
2.4 Aktivitetet e shërbimit për informim	23
III. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV	25
3.1 Aktivitetet - Prill-Qershor 2013	25
3.2 Personeli	26
3.3 Raport I zyrës ligjore	27
3.4 Aktivitetet e zyrës së Teknologjisë Informative	31
IV. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR	31
4.1 Aktivitetet - Prill-Qershor 2013	32
4.2 Raport I performancës financiare- TM_1 - TM_2 - 2013	33
V. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM	38

ORGANOGRAMI

SHTESA I: Raporti I Investimeve

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



I. SHËRBIMI TEKNIK

1.1 Aktivitetet – Prill-Qershor 2013

Furnizimi

Edhe pse prurjet e ujit ne burimet e vjetra me gravitet kane filluar te ken rritje por jo ne mas te duhur, fale shtimit te kapacitetve te reja te ujit te pijes tek lokacioni „40 Burimet“ kemi arritur te kemi gjendje stabile te furnizimit me uje per te gjithë qytetin e Prizrenit me regjion e sidomos për konsumatorët që furnizohen me sistem te gravitetit.

Kompania është angazhuar dhe ja ka arritur qe ne tre mujorin e dyte te vitit 2013 te furnizojë të gjithë konsumatorët me uje te pijes 24 ore ne perjashtim te zonave te larta te cilat furnizohen me sistem te pompimit ku dhe kemi reduktime te shkurtëra brenda dites (*Kryesisht Laxha Dardania*). Në Njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka pasë probleme me furnizim me uje te pijes dhe duke u bazuar ne raportet e Njesive Operuese kemi patur furnizim pa nderprerje me uje te pijes.

Uji i prodhuar

Për muajin TM-2 (tre mujorin e dyte) te vitit 2013 ne nivel regjional janë raportuar prodhim te ujit, **4,861,405.00 m³** krahasuar me TM-1 kemi nje rritje te prodhimit te ujit te pijes prej **304,004.m³**. Jane duke vazhduar aktivitetet në sigurimin e burimeve te reja te ujit te pijes, ne kaptimin e ketyre sasive te reja si dhe injektimin e kesaj sasie ne rrjetin distributiv.

Uji i pa faturuar

UPF vazhdon te mbetet nje sfide kryesore e te gjitha sherbimeve te kompanise, ku ne bashkpunim me te gjitha sherbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve te huaj dhe instutucioneve vendore kemi planifikuar shume aktivitetet kryesisht ne zvogelimin e UPF-se.

Kompania ne nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore per zvogelimin e UPF-se qe nenkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohe te defekteve ne teresi.

Shërbimi Teknik me te gjithë sektoret e tije është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u perpjekur për sanimin e tyre sa më të shpejtë. Kompania eshte duke i vazhduar aktivitetet per zvogelimin e UPF-se dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Eshte formuar grupi i veçant brenda Depertamentit Teknik per verifikimin e rrjetit shperndares dhe verifikimin e valvulave ne qytetin e Prizrenit. Deri me tani eshte verifikuar rrjeti shperndares si dhe janë duke i berë analizat neper zonat e furnizimit.

Raportet tregojne qe UPF ne nivel regjional per TM-2 te vitit 2013 eshte **59.98%** ose **0.59%** me pak humbje nga TM-1.

Faturimi ne nivel regjional eshte prej **1,945,689.00 m³** me nje rritje te faturimit krahasuar nga TM-1 prej **148,504 m³** .

Aktivitetet e shërbimit Teknik në nivel regional kanë qenë të parreshtura dhe janë orientuar në mundësinë e furnizimit sa më të rregullt me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët që kjo kompani i mbulon, si dhe në aktivitetet teknike për uljen e humbjeve si atyre teknike poashtu dhe atyre administrative respektivisht uljen e vlerave të UPF-se.

* Kohë më parë është bërë hapja e pesë puseve tek 40 burimet më thellësi përafërsisht nga 50 metra si dhe fillimi e punimeve për hapjen e galerisë duke krijuar lidhjet e puseve me një sistem të përcjellës në gypin kryesor me qëllim për të furnizuar me ujë tërë qytetin e Prizrenit, dhe këto puse sjellin një sasi të ujit afërsisht 110 l/s, kështu që kjo galeri mundson rrjedhje të ujit me ramje të lire si dhe sipas nevojës edhe me sistemin e pompave.

* Nga Departamenti Teknik janë plotësuar dokumentacionet e nevojshme për Pelqimet-Lejet përkatëse të cilat janë dërguar në MMPH dhe në Komunën e Prizrenit për projektin Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujerave të Zeza. Pasi që lidhur me lejet përkatëse për ndërtimin e ITUZ-se, janë dy institucionet përgjegjëse:

- ✚ Ministria përgjegjëse për çështjet mjedisore që lejon projektimin, sistemin dhe shkallën e procesit të trajtimit, dhe

- ✚ Komuna e Prizrenit e cila për rehabilitimin dhe ndërtimin e dy kolektoreve si dhe ndërtimin e ITUZ-se do të jep lejen përkatëse.

* Nga komuna e Prizrenit jemi në procedurë të rregullimit të dokumentacionit përkatës, ku në Drejtorinë e Shërbimeve Publike është leshuar një pelqim për mundësinë e manovrimeve teknike të cilat kanë të bëjnë me projektin, kurse nga Drejtoria e Urbanizimit janë leshuar kushtet urbanistike të cilat duhet të plotësohen dhe është marrë leja e influentit për ujra të zeza.

* Në muajin Maj janë zhvilluar takime me përfaqësuesin e fshatit Lugizhdë e Hasit lidhur me rastin e pusit të vjetër të cilën pompa e ujit është e fundosur dhe nuk është duke furnizuar me ujë banoret, kjo është bërë nga individët e caktuar.

* Është mbajtur takimi me grupin e ekspertëve për Strategjinë Kombëtare të investimeve në sektorin e ujit të pijes dhe ujerave të zeza.

* Në takim me menaxhmentin e „Hidroregjionit“ jemi dakorduar për shkak të keqperdorimit të ujit të pijes nga disa konsumator, lagje ose fshatë të mos ketë furnizimi të rregullt me ujë të pijes aty ku humbjet janë të mëdha në baze të matjeve nga ujëmatësit zonal, këto zona do të aplikohen në të gjithë regjionin e Prizrenit.

* Është nënshkruar Marrëveshja me përfaqësuesin e fsh. Kabashë, HRJ si dhe nga Kryetari i Komunes së Prizrenit. Nga kjo marrëveshje sistemi i ujit të pijes kalonë nën menagjimin e Hidroregjionit jugor, ku ekipet tona e kanë verifikuar gjendjen e ujesjellesit dhe të kanalizimeve në fshatë si dhe kanë bërë instalimin dhe blombimin e ujëmatesave të të gjitha konsumatorëve.

* Me kërkesën e firmës NPT „ART-COM“ për hulumtimin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit i lejohet firmës „art-com“ të bëjë kyqjen e aparaturave në gypat e ujit për të hulumtuar prodhimin e energjisë elektrike dhe pas hulumtimit do të paraqet firma një raport të gjendjes reale për prodhim të energjisë elektrike.

* Në muajin Shkurt nga MZHE janë nënshkruar dy marrëveshje për të financuar projektin për ndërtimin e rezervarit tek „Pusi Atit“ me shumën prej 500 mijë euro, si dhe për rrugën e „Muhagjerëve“ me shumën prej 119 mijë euro ku departamenti teknik ka përgaditur komplet dokumentacionin, njëherit është shpallur edhe tenderi për rrugën e „Muhagjerëve“ në të cilën

firma fituse ka perfunduar punimet ne afat te parapar me baze te kontrates, kurse per ndertimin e rezervarve pritet se shpejti te behet hapja e tenderit.

* Sa i perket projektit te fshatit KOBALJ "Reduktimet e humbjeve per fshatin KOBALJ DMA ZON" te investuar nga K-WISER, eshte perfunduar projekti kryesor per implementim e ketije projekti. Ky projekt është investuar nga USAID dhe nga K. Prizrenit shuma e perafert eshte rreth 160.000.00 euro, ku prej kesaj shume Komuna e Prizrenit ka investuar 50,000.00 Euro dhe ka bere pagesen ne baze te marreveshtjes se paraparë si dhe eshte bere edhe pranimi teknik, kurse „H.R.J“ ka bërë vendosjen e ujëmatsëve për të gjithë konsumatorët.

* Në fsh. Mushtisht kemi perfunduar punimet me vendosjen e ujëmatesave duke angazhuar ekipe shtes edhe nga Dragashi dhe nga Malisheva, si dhe ekipet e montimit tani jan duke i vendosur ujmatit tek konsumatore te cilet deri me tani jan nenshtruar pageses paushalle, kemi angazhuar ekipe shtesë nga Dragashi dhe Malisheva, si dhe eshte bere rregjistrimi i konsumatoreve te rinjë.

* Ne muajin Maj jane bere shpime te puseve ne fsh.Sallagrahd per qytetaret e komunes se Suharekes, deri me tani jan shpuar njembdhjet puse ku jane siguruar 100 l/s dhe jemi ne vazhdim të shpimeve te puseve tjera me qellim qe furnizim me uje te jetë i mjaftueshem per Suharekën dhe fshatrat per rrethë. Njeherit ka filluar edhe procesi i tenderimit per ndertimin e rezervarit projekë i cili financohet nga Qeveria e Kosoves - MZHE.

* Sa i perket Projektit Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujerave te Zeza tani me jemi ne fazen e perpilimit te konceptit kryesore ne lidhje me Fillimin e projektit Detal, Kompania P2M dhe ajo Vendore Alb-Architect jane vendosur ne Objektet e HRJ-se dhe ne bashkpunim me Stafin Teknik te HRJ-se jane duke u grumbulluar informacione teknike dhe administrative te cilat do te ndikojne ne mbarevajtjen e projektit. *(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi).*

* Në muajin Maj janë bërë leximet e ujmatve zonal me qellim per te verifikuar hargjimet e ujit neper zonat e veqanta dhe prej tyre tre ujëmatsa zonal rrezultojnë se nuk bejnë matje te sakt ,andaj eshte njoftuar firma pergjegjse per te riparuar këto ujëmatsë.

* Jane pergaditur komplet dokumentacionet per aplikmin e lejes Ujore pran MMPH, me çrast dhe jane dorezuar Aplikacionet ne Depertamantin e Ujerave, presim pergjegje nga Departamenti perkates. Edhe ne muajin Maj te vitit 2013 nuk eshte leshuar Leja Ujore nga Departamenti i Ujerave prane MMPH ne Prishtine gjate keti muaji jemi paisur me leje nga MMPH per hulumtime te ujit.

* Takim me perfaqesusin e Komunes se Mamushes per realizimin e projektit per shpimin e puseve si dhe vendosjen e trafos per furnizim me energji elektrike, si dhe nga perfaqesusi i komunes se Mamushes jemi informu se TIK-u ka zotuar shumen prej 90 mije euro per kete projekt. Deri me tani nuk asnje informat konkrete ne lidhje me financimin e ketije projekti.

* Eshte berë hulumtimin e ujit te pijes në komunën e Malisheves për shpimin e puseve ne fsh.Senik si dhe po vazhdohet per hapjen e puseve tjera me qellim per te furnizuar edhe fshatrat per rrethe te Malisheves.

* Ne takimet me Kryetarin e Dragashit jemi dakorduar te behet pregaditja per nenshkrimin e marrveshtjes per fsh.Brezne qe te kalohet nen menagjimin e Hidroregjionit, andaj ekipet tona kan verifikuar gjendjen reale te ujesjellesit dhe pritet se shpejti te behet nenshkrimi i marreveshtjes.

* Departamenti teknik ka bërë të gjitha pregaditjet për të zgjidhur problemin e ujit të pijes për qytetin e Prizrenit dhe ka bërë projekte ideore dhe shumen e perafert, me qellim që këto projekte ideore të prezentohen në një të ardhem asambles komunale në Prizren.

* Për shkak të reshurave të mëdha gjatë muajit Qershor janë bërë pastrimet e Rezervuarve nën kalë si dhe është demtuar gypi furnizues tek 40 burimet për qytetin e Prizrenit.

* Gjatë muajit Maj janë bërë dedektimi dhe kontrollimi nga ana e kontrolles të të gjithë konsumatorve në lagjen e „Bajram Curri“ dhe kemi nxjerrur një raport për gjendjen reale dhe të furnizimit me ujë.

1.2 Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrur për eliminimin e humbjeve teknike

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale,
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujesjellesit dhe ndarja e zanave për dedektim.
- ✚ Senzibilizimin e të gjithë konsumatorëve për mos keqperdorim të ujit të pijes përmes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre të shkruara,
- ✚ Ngritjen e vetedijes të të gjithë konsumatorëve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatorëve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

1.3 Planifikimi i investimeve emergjente të kompanisë për përmirësuar situatën e furnizimit me ujë të pijës

Implementimi i pjesës së parë dhe të dytë të Fazës së Dytë të projektit kryesor „40 Burimet“ i cili parasheh:

Ndërtimin e Komorës ujëmbledhëse dhe injektimin e sasise së re të ujit të pijes në rrjetin distributiv të qytetit të Prizrenit. Është përpiluar projekti ideor i ndërtimit të galerisë percjellese dhe ndërtimi i komorës kryesore i cili për të realizuar arrin vlerën e perafert prej rreth 180,000.00 Euro, dhe hulumtimi dhe kaptimi i burimeve ekzistuese në afërsi të kaptazhës së IV-të i cili kap vlerën prej 220,000.00 Euro.

Vendosjen e linjës së veçantë nga Marashi deri tek ETC-ja që parasheh ndarjen e zonave të furnizimit. Ndarjen e furnizimit të fshatrave dhe lëshes Bajram Curri nga rrjeti furnizues i qytetit, nga departamenti teknik është hartuar projekti i cili kap vlerën e perafert prej 196,000.00 Euro.

Kompania HIDROREGJIONI JUGOR në Planin e Biznesit dhe në Strategjinë Zhvillimore ka planifikuar edhe planin afatgjatë të investimeve për ujesjelles dhe kanalizim.

Në bashkëpunim me K. e Prizrenit kemi hartuar planin investiv për ujë dhe kanalizim në të cilin kemi paraqitur planin dhe dinamikën e perfundimit të këtyre punimeve me të cilat planifikojmë të zgjidhim perfundimisht furnizimin 24 orësh me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët e regjionit të Prizrenit ku kjo kompani i mbulon. *(Ekziston Plan i investiv i Kompanisë i cili duhet të rivedohet në fillim të vitit ose në gjashtë mujorin e parë të vitit 2013.)*

Zgjerimi i veprimtarisë së Kompanisë për marrjen e sistemeve Rurale nën menaxhimin e HRJ-se.

Kompania ka përpiluar hartat me mbulueshmeri të cilat i bashkëngjiten këtij raporti.

Menaxheri Teknik ka perpiluar planin e investimeve per vitin 2013, 2014 dhe 2015 dhe eshte i gatshem qe kete plan ta prezantoje para Kryeshefit dhe menaxhmentit te larte, plani eshte bere ne periudhen perkatese dhe ka vend per permiresime.

Prodhimi i ujit m³ Prill – Maj - Qershor 2013

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	3,985,192.00	43,793.32	506.9	
Suharekë	466,689.00	5,128.45	59.4	
Dragash	116,312.00	1,278.15	14.8	
Malishevë	293,212.00	3,222.11	37.3	
Total	4,861,405.00	53,422.03	618.3	

1.4 Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve Prill - Maj- Qershor 2013

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	343	221	564
Suharekë	65	12	77
Dragash	15	0	15
Malishevë	43	8	51
Total	466	251	707

* Sektori i operatives është mirë i organizuar dhe i mobilizuar. Deri më tani ka arrit që defektet e paraqitura në rrjetin e ujësjetësit dhe kanalizimit ti evitojë me kohë.

* Jemi ne pergaditje te planit per ndarje te sherbimit te ujit nga kanalizimi.

1.5 Zyra për planifikim dhe zhvillim Prill - Maj - Qershor 2013

Për periudhen qe po raportojme ne kuader te zyres se Plan Zhvillimit grupet e organizuara te cilat veprojne ne terren kanë vazhduar blombimet nëper qytetin e Prizren'it për të kryer refreshimin këto kanë arritur keto rezultate.

- Ujematësa te bllobuar 385 Ujematësa.
- Kontrata te nënshkruar 385 Kontrata
- Konsumatorët qe ekipa jon nuk ka pasur qasje 307 konsumator, kjo mosqasje është përciellë nga ekipa dhe here pas here jan vizituar deri sa kane arritur te kene qasje.
- Konsumatorët qe ekipi konstatoj qe duhet te zavëndsohet ujematësi janë 22 Konsumator.
- Nuk ka pasur konsumatorët per shak nuk jane mujte te blombohet per shak kushteve teknike .
- Nuk ka pasur konsumatorët pa ujematës 1.
- Konsumator te paregjistruar janë 11 .

- Nuk ka pasur rekorde treja per blockmapping .

Nr.	Përshkrimi	Total
1	Blombim-Kontrata	385
2	Dera Mbyllyr (Heren e dyte)	307
3	Pa Regjstruar	11
4	Zavendsime	22
5	Pa Ujemates	7
6	Rekorde treja per blockmapping	0

Aktivitetet kryesore

Në zyrën eGIS'it ë zyrën eGIS'it është bërë instalimi I programit Navigion për exportimin të dhënave nga faturista, si dhe është bërë ndërlidhja faturimin me GIS.

*Vizatimi i hartave prej terrenit nuk ka pasur asnje ndryshim, për shak se ekipet e terrenit kanë qenë të ngarkuar me bllobime dhe nënshkrime të kontartave në teren.

*Gjatë këtij muaji është punuar në vendosjen e ujëmatësave në fshatin Mushtisht komuna e Suharekës, ku gjatë punëve për vendosjen e ujë 137matseve kanë marrë pjesë 4-5 grupe.

Punët kanë filluar me datë:12.03.2013 dhe kanë përfunduar në këtë muaj me datë 03.04.2013 .Ku gjithësej janë bërë 297 kontrata (vendosje të ujëmatësave).

* Formimi i 5 (pesë) grupeve të terrenit për identifikimin e konsumatorëve pa ujëmatës (paushall) si dhe paisja e konsumatorëve me ujëmatës në qytetin e Prizrenit.

* Me datë 15.04.2013 takim në mes palëve: Kocks konsulent Gjerman (firm Gjermane), Hidroing dhe Hidroregjioni Jugor.Tema e takimit ka qenë ndërrimi i rrjetit transportues të lokacioni 40 Burimet – Prizren. Në mes palëve ka pas takime gjatë tërë javes, shkëmbim të ideve si dhe ofrimin e të dhënave për këtë lokacion.

* Me datë 19.04.2013 është bërë pranimi teknik i projektit "Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit Kobaj" - Prizren

* Ekipet e detektimi të rrjetit të ujësjellësit kanë bërë gjithësej 42 detektime, gjatë detektimeve kanë hasur në 15 defekte, (Ekziston raporti i veçanët).

* Është bërë leximi dhe monitorimi I ujëmatësve zonal, ku 1(një) prej ujëmatësave zonal nuk punon.

* Në zyrën e GIS'it katër harta (7F12-12-05, 7E12-20-02, 7E12-30-03, 7F12-12-04) janë duke vektorizuar edhe duke pregaditur për të transferuar në programin e GIS'it.

* Stafit GIS'it është takuar me përfaqësuarit e Kuvendin Komunes së Prizrenit Departamentinë e Kartografisë. Sipas sistemit e vjeter blockmappingut sistemi koordinativ ka qenë sipas Gaus Krygerit. Eshtë marrë të dhënat e Kosova Ref edhe është duke transferuar në sistemin e GIS'it.

* Shumica prej të dhënave janë importuar në program por ka mbetur vetëm të importohen të dhënat për banesat edhe të transferuan sistemi koordinativ.

* Takim në mes të Assecos dhe KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh.a me date 02.05.2013 dhe me 27.05.2013.Tema e takimit të arriturat në projektin"Implementimi dhe aplikimi i plotë i programit softwerik shum dimensional-Microsoft-Navision".Ky projekt është mbështetur nga donatori potencial USAID-KWISER.

* Në këtë muaj janë formuar grupet të terrenit për vendosjen e ujëmatësave të ri në fshatin Kobajë, dhe pas leshimit të rrjetit të ri ekipet tona janë duke hequr ujëmatësat e vjeter.

* Është bërë leximi dhe monitorimi I ujëmatësve zonal për këtë muaj,ku një prej ujëmatësave nuk bene leximin e ujit të shpenzuar.

* Me datën 04-26.06.2012 kanë nisur blombimet në Kabash të Has'it. Ujematesa të instaluar janë 25, ujëmatësata blombuara 50, konsumatorët me të cilave nuk kanë pasur

qasje janë 7, konsumatorët pa ujëmatës janë 1, konsumatorët të regjistruar por që nuk kanë pasur lidhje uji 3.

* Në zyrën e GIS'it harta të përfunduara edhe me dhënat e terrenit janë 2 harta (7F12-11-05, 7F12-12-05) janë përgaditur për të transferuar në programin e ArcGIS'it.

* Shumica prej të dhënave janë importuar në program por ka mbetur vetëm të importohen të dhënat për banesat edhe të transferuan sistemi koordinativ.

* Ekipet e detektimit të rrjetit të ujësjesit kanë bërë gjithësej 44 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 23 defekte, Ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 3960 m.

* Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësve zonal për këtë muaj, ku 1 prej ujëmatësve nuk është lexuar për arsye se ujëmatësi është defekt në vendin e quajtur të ura, (ura e Gani Tades).

* Në këtë muaj ka vazhduar montimi dhe kontrollimi i konsumatorët pa ujëmatës si dhe të konsumatorët me faturim paushall në Prizren.

- Ujëmatësa të montuar 35 : 17 me pages , 18 pa pages

- Konsumator pa ujëmatës të regjistruar 44.

Hartat e importuara me lidhje uji ne programin edhe nderlidhura me programin ArcGIS 10	Hartat të cilat duhën të vizatohën prej terrenit	Hartat malore te cilat nuk ka nevojë te vektorizim	Hartat te cilat jane vizatuar prej terrenit
1. Harta 7F12-11-07	1. Harta 7E12-20-08	1. Harta 7E12-30-11	1. Harta 7E12-20-02
2. Harta 7F12-11-08	2. Harta 7E12-20-11	2. Harta 7F12-12-16	2. Harta 7E12-20-05
3. Harta 7F12-11-09	3. Harta 7E12-20-14	3. Harta 7F12-22-01	3. Harta 7E12-20-17
4. Harta 7F12-11-10	4. Harta 7E12-30-05	4. Harta 7F12-22-04	4. Harta 7E12-30-02
5. Harta 7F12-11-11	5. Harta 7E12-30-05	5. Harta 7F12-22-07	5. Harta 7E12-20-03
6. Harta 7F12-11-12	6. Harta 7E12-30-08	6. Harta 7F12-22-10	6. Harta 7E12-20-15
7. Harta 7F12-11-13	7. Harta 7E12-30-11	7. Harta 7F12-21-09	7. Harta 7F12-20-18
8. Harta 7F12-11-14	8. Harta 7E12-20-06	8. Harta 7F12-21-12	8. Harta 7E12-30-03
9. Harta 7F12-11-15	9. Harta 7E12-20-09	9. Harta 7F12-21-11	9. Harta 7E12-30-06
10. Harta 7F12-11-16	10. Harta 7E12-20-12		10.Harta 7E12-30-09
11. Harta 7F12-11-17	11. Harta 7E12-30-12		11.Harta 7E12-12-04
12. Harta 7F12-11-18	12. Harta 7F12-11-01		
13. Harta 7F12-21-01	13. Harta 7F12-11-04		
14. Harta 7F12-21-	14. Harta 7F12-21-07		

02			
15. Harta 7F12-21-04	15. Harta 7F12-21-10		
16. Harta 7F12-21-05	16. Harta 7F12-11-02		
	17. Harta 7F12-11-05		
	18. Harta 7F12-21-08		
	19. Harta 7F12-11-03		
	20. Harta 7F12-11-06		
	21. Harta 7F12-21-03		
	22. Harta 7F12-21-06		
	23. Harta 7F12-12-01		
	24. Harta 7F12-12-07		
	25. Harta 7F12-12-10		
	26. Harta 7F12-12-13		

Shërbimi i dedektimit të rrjetit të ujësjesit

Prill - Maj - Qershor - 2013

Gjatë muajit Prill –Qershor 2013 ekipa e dedektimit kanë bere dedektimin e rrjetit te ujesjellesit ne lagjen “Bajram Curri” dhe “Jeta e Re” si dhe pjeset tjera te qytetit me nje gjatesi prej 9,925 m. si dhe kanë kryer dedektime ne baze te kerkesave te konsumatorve .

Gjatë dedektimit te rrjetit kan gjetur 63 rrjedhje te ujit ku kan njoftuar ekipet e operatives dhe jan sanuar defektet me kohe kurse ka pasur raste te lajmruar nga konsumatorët per rrjedhje te ujit por nuk kan gjetur rrjedhje te ujit.

Aktivitetet e tyre janë të shënuara si më poshtë:

- Pune efikase ditore në bazë të nevojave të kompanisë për operacione të Detektimit të ujit.
- Analizimin dhe Kontrollimin e kërkesave te konsumatorëve te ujit.
- Menaxhimin dhe raportimin për zhvillimin e aktivitete në të gjitha aktivitetet e lartshënuar.

Në kuadër të aktiviteteve të lartshënuara ju prezantojmë këto rezultate :

- * Gjatësia e rrjetit të detektuar – **9,935 m**
- * Prurjet e gjetura gjatë detektimit – **2.3 l/s**
- * Kërkesa të shqyrtuara – **111**
- * Defekte të gjetura – **63**
- * Defektet e pa gjetur – **21**

1.6 Shërbimi i mirëmbajtjes – Servisimi i ujëmatësave: $\Phi(13 - 100)$ mm

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipen e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit. Ky shërbim bënë servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Njësia Operative	Profili \emptyset mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	124	
	3/4"	231	
	1"	30	
	5/4"	0	
	6/4"	2	
	Gjithsejt:	387	
Suharekë	1/2"	5	
	3/4"	15	
	1"	0	
	Gjithsejt:	20	
Dragash	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Malishevë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	1	
	Gjithsejt:	1	

Totali : 408 copa

Raporti Tremujorë i punës - Njësia Suharekë

*Furnizimi me ujë (Prill,Maj,Qershorr)-Furnizimi me ujë gjatë dy muajve të parë të këtij tre mujori ka qenë i mirë ndërsa në fillim të muait të fundit ka pasur reduktime pasiqë është vërejtur mungesë e ujit e cila ka ardhur si pasojë e një defekti në gypin e Pusit Atit afër lumit i cili me vështirësi është vërejtur pasiqë ka rrjedhur një sasi jo shumë e madhe,mirëpo me aktivizimin e një pompe të re uji ka dalë në sipërfaqe dhe është rregulluar ky defekt.

*Analizat e ujit (Prill,Maj,Qershorr)-Gjatë këtij tre mujori janë realizuar gjithësej 15 teste të analizave bakteriologjike të ujit ku nga 15 testet e realizuara 3 nuk i'u kanë përgjigjur standartëve. Arsyeja pse këto teste nuk i'u kanë përgjigjur standardeve ka qenë pasiqë është rritur sasia e ujit mirëpo nuk është rritur edhe doza e klorit e cila më pastajë është rregulluarë.

*Analizë e humbjeve teknike të ujit- Me paraqitjen e problemit me furnizim është bërë një analizë detale e rrjetit të ujësjellësit duke i analizuar hargjimet e ujit në bazë të ujëmatësave zonalë në qytet për secilën rrugë janë zbuluar disa rrjedhje të vogla të cilat janë rregulluar mirëpo nuk ka ndryshuar gjendja e furnizimit derisa është rritë sasia e ujit duke e montuar edhe një pompë në SP-Pusi Atit dhe një kontrollë në linjen e Pusi Atit-Rez.Shirokë, me

zbulimin dhe rregullimin e defektit në gypin 450mmPE është ndërprerë edhe një pomë te Pusi Atit pasi që ka furnizim të mjaftushëm.

*Defektet në rrjetë të ujësjellësit dhe kanalizimit (Prill,Maj,Qershor)-Gjatë këti tre mujori janë paraqitur dhe rregulluar 69 defekte në rrjetë të ujësjellësit dhe 10 defekte në rrjetë të kanalizimit

*Defektet në stacionet e pompimit (pompa) (Prill,Maj,Qershor)- Gjatë këtij tre mujori në stacionet e pompimit (pompa) janë paraqitur 12 defekte dhe janë rregulluar ku janë djegur 3 pompa të cilat janë zëvendësuar 2 në Samadraxhë 1-7.5 kw dhe 1-18.5kw dhe te Pusi Atit 1-30kw gjithashtu është shtuar edhe një pompë e re 18.5 kw te Pusi Atit

*Vazhdimi i projektit në shtrirjen e rrjetit sekondar në Mushtishtë- Është rifilluar në shtrirjen e rrjetit sekondar në një rrugë e cila është palanifikuar nga KK-Suharekë të rregullohet me kubza e që për këtë arsye është kërkuar që komplet dheu i gërmuar të transportohet dhe komplet kanali të mbushte me zhavorë. Janë përfunduar L=1200m në shtrirjen e rrjetit dhe realizimin e kyqjeve sekondare.

*CDI-a ka bërë furnizimin me gypa për komplet projektin në pjesën e dytë me gjatësi L=6km dhe vetëm L=1.2km është përfunduar.Për shkak të presionit të madhe kemi qenë të obliguar ta vendosim një rregullator të presionit i cili është vendosur në qendër të fshatit ka mbetur të përfundohet puseta.Janë vendosur 250ujëmatësa dhe janë regjistruar si konsumatorë të ri.

*Vazhdimi i projektit në hapjen e pusëve për shtim të sasisë së ujit në lokacionin “Krisma e Sali Shabanit” –Baçec- Janë hapur 9 puse, janë siguruar 75 l/s është duke u vazhduar në hulumtimin e ujit edhe në pjesën rrëzë bjeshkës punimet janë duke u vazhduar ku sipas të dhënave në terren shihet se ka sasi të madhe të ujit.

*Është realizuar vizita ne terren nga ana e operatorëve ekonomik të cilët do të tenderojnë në ndërtimin e rezervarit me vëllim $V=3*1000m^3$ dhe gypit deri te gypi i Pusit Atit, janë duke vazhduar fazat e tjera të këtij tenderi.

*Montimi i trafës për stacionin e pompimit “Krisma e Sali Shabanit” –Baçec- Është bërë montimi i trafës me të gjitha pjesët përcjellëse dhe është relizura linja e tensionit të lartë me gjatësi L=350m

*Rritja e sasisë së ujit për fshatin Sallagrazhdë- Është bërë hapja e një pusi të ri për fshatin Sallagrazhdë ku janë shtuar 5l/s dhe është bërë ndërpreja e një sasi të ujit me gravitet e cila herë pasë here e sidomos gjatë reshjeve atmosferike është turbulluar.

*Zgjerim i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Studenqan-Në fshatin Studenqan është zgjeruar rrjeti me gjatësi L=200m DN-63mm dhe njëkohësisht është shtuar edhe zona e mbulimit me ujë me gravitet dhe kjo ka qenë arsyeja e investimit ne këtë zonë e realizuar nga ana e kompanisë.

Raporti Tremujorë i punës - Njësia Malishevë

Gjatë periudhes tre mujore janë marrur masat duke bere nderrimin e ekipes se kontrolles ku tani kam emëruar tre punëtorë tjerë dhe vetem ne javen e fundit te muajit qershor ka arrite te inkasoj 1197.43€. shume kjo te cilen ekipa paraprake e kontrolles nuk ka arrite ta realizoj as per nje muaj.Hapi tjeter qe planifikoj te marre si pergjegjes i Njesise ne Malisheve eshte nderrimi i tereneve per tre inkasant me performance me te ulet.Ky hap eshte planifikuar me qellim te shterrjes se te gjitha mundesive para se te mirret ndonje mase perjashtuese te punetoreve me performance te dobet nga puna.

Nder shkaqet tjera qe po e rendojne gjendjen financiare te njesise ne Malisheve jane edhe mospagesa me rregull e faturave nga ana e institucioneve,pastaj aktivite te shumta te realizuara nga njesia rreth hulumtimeve te burimeve te ujit ne fshatin Senik ku kemi bere shpimin e pese (5) puseve dhe kemi gjetur mbi 100 l/s.Ne keto hulumtime ne kemi angazhuar nga tre punetor çdo dite dhe kjo ka ndikuar ne mos permbushjes se inkasimit

Pastaj ,rritja e shpenzimeve te energjise elektrike si rezultat i shtimit te stacioneve pompuese gjithashtu po ndikon ne performance te njesise.

Aktivitetet që duhet shtuar për të qenë Njësi operuese e suksesshme janë:

- 1.Rritja e bashkepunimit me Komunitat –nenshkrimi i memorandumeve te bashkepunimit
- 2.Paisja me ujemates e te gjithë konsumatoreve
- 3.Leximi i sakt i ujematesave
- 4.Dergimi me kohe i Njoftimeve per shkyqje
- 5.Shperndarja me kohe e faturave
- 6.Kontrolle rigoroze per te gjithë konsumatoret
- 7.Evitimi i shpejt i defekteve ne rrjet
- 8.Zbulimi i kyqjeve ilegale dhe keqperdoruesve te ujit
- 9.Shkyqja e te gjithë konsumatoreve me borgj mbi 500 €
- 10.Degimi i sa me shume lendeve ne gjykata dhe prioritetizimi i tyre
- 11.Largimi nga puna i punetoreve me performance te dobet,
- 12.Insistimi ne uljen e çmimit te energjise elektrike nga zrire-ja
- 13.Rastet sociale duhet ti marre Qeveria.

Raporti Tremujor i punës - Njesia Dragash

Gjatë tremujorit të dytë (Prill -Maj-Qershor), në njësinë operuese në Dragash furnizimi me ujë ka qenë i rregullt (24 orë) pa reduktime dhe nuk ka pasur probleme të theksuara në furnizimin e qytetarëve me ujë.

Trajtimi i ujit (sedimentimi, kaugulimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi si dhe janë kryer punët vazhdimisht në pastrimin e pusetave si dhe punë tjera në kaptazhën e fshatit Radeshë.

Analizat e ujit janë bërë në vazhdimsi dhe i përgjigjen standardeve të parapara të ujit të pijshëm.

Janë kryer punë në vendosjen e gypit në një gjatësi prej 1000 m për lagjen e fshatit Shajne si dhe është bërë rexhistrimi i klientëve të fshatit Brezne, janë bërë kontrata (214) me ta si dhe është verifikuar gjendja momentale e rrjetit të ujsjellsit në këtë fshat për qka dhe ju kemi njoftuar me raport të veçant.

Në këtë tremujor, njësia jonë ka pasur performancë pozitive ndërsa shpenzimet në njësi kanë qenë minimale.

Shpenzimet janë shtuar në të ardhurat personale sepse janë pranuar dy punëtor të ri ku njëri nga ta gjatë dy muajve të fundit asnjë ditë nuk është paraqitur në punë në njësinë tonë ndërsa pagën e merr nga njësi jonë.

Humbjet e ujit gjatë këtij tremujori janë sjellur rreth 50 % që janë kryesisht si pasojë e rrjetit të vjetruar të ujsjellsit.

Nga muaji në muaj, në Njësinë Operative në Dragash mund të ketë lëvizje si të faturimit poashtu dhe të inkasimit nga fakti se një pjesë e konsiderueshme e banorëve jetojnë në vende të tjera brenda dhe jashtë Kosovës dhe kohë pas kohe në periudha të caktuara qëndrojnë në shtëpitë e tyre.

1.7 Raporti i analizave mbi cilësinë e ujit të pijes për –TM₁-TM₂

*Janë marrun gjithësejt 278 mostra në nivel regional për analiza Bakteriologjike dhe prej tyre 273 mostra i përgjigjen standardeve të ujit të pijes e 5 mostra nuk i përgjigjet.

*Janë marrun 117 mostra në nivel regional për analiza Fiziko-Kimike dhe 114- iu përgjigjen standardeve për ujin e pijes,e 3 mostra nuk u përgjigjen.

Mostrat e marruna nëpër njësi:

*Prizren : Bakteriologjike- Gjithsejt janë 213 mostra prej tyre 208 i përgjigjen 5 nuk i përgjigjen

Fiziko-Kimike --Gjithsejt janë 89 mostra dhe të 89-tat i përgjigjen,

*Suharekë: Bakteriologjike- Gjithsejt janë 40 mostra dhe 37 i përgjigjen standardit për ujë të pijes

dhe 3 mostra nuk i përgjigjen.

Fiziko-Kimike –Gjithsejt 16 mostra dhe të 16-tat i përgjigjen

*Malishevë: Bakteriologjike - Gjithsejt 16 mostra dhe të 16-stat i përgjigjen .

Fiziko-Kimike - Gjithsejt 7 mostra e prej tyre 4 mostra u përgjigjen e 3 mostra nuk i përgjigjen. *Dragash:Bakteriologjike- Gjithsejt 9 mostra e prej tyre 7 mostra i përgjigjen dhe 2 nuk u përgj.

- Lokacionet ku janë marrun mostrat për Prizren:

Kroje publike , Kroje në Restorane ,Kroje në shkolla ,Kroje në spitale dhe ambulanta,Kroje në furra

Si dhe në kroje të ndryshme,

Mostra janë marrun edhe në Rezervuaret dhe burimet tona.

Në mënyr të njëjtë janë marrun mostrat edhe nëpër njesitë tjera.


P.s. mostrat të cilat nuk i përgjigjen në Prizren janë mostra të cilat janë marrun më 14/06/13 ku për shkak të reshjeve të tepruara të shiut ka ardhur deri te rritja e sasis së ujit të lumit dhe depërtimi i tij në burime dhe si pasojë e sajë janë këto rrezultate, këto mostra më pas janë përsëritur më 17/06 dhe 25/06/13 dhe në të dyja rastet mostrat u janë përgjigjur standardit për ujë të pijes.

Shkaku i reshjeve të mëdha të shiut rezultoi edhe te ndotja e burimeve edhe në Malishevë(paraqitja e turbullirës)

Masat e marruna pas kësaj situate ishte pastrami i rezervuareve nga depërtimi i ndotëjeve dhe dezinfektimi i tyre me klor në formë të hipokloritit të natriumit ku si rezultat kemi përsëritjen e marrjes së mostrave dhe rrezultatet e tyre janë në përputhe me standardet e lejuara për përdorim të ujit për pije,këto mostra krahas I.SH.P janë marrun edhe nga ana jonë dhe janë punuar në laboratorin e kompanisë.


Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike – Janar-Mars 2013

Muaji	Nr. Total	Biologjike			Kimike		
		Nr. Total	Pergj.	nuk i pergj.	Nr. Total	Pergj.	nuk i pergj.
JANAR	144	101	101	0	43	42	1
SHKURT	152	106	105	1	46	46	0
MARS	172	120	117	3	52	52	0
Total	468	327	323	4	141	140	1
% e Deshtimeve				1.2			0.7
% e Desht. Total							1.1



PRILL-QERSHOR- 2013

Muaji	Nr. Total	Biologjike			Kimike		
		Nr. Total	Pergj.	nuk I pergj.	Nr. Total	Pergj.	nuk I pergj.
PRILL	124	88	87	1	36	36	0
MAJ	129	89	89	0	40	38	2
QERSHOR	144	101	92	9	43	40	3
Total	397	278	268	10	119	114	5
% e Deshtimeve				3.6			4.2
% e Desht. Total							3.8



1.8 RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE JANAR-MARS – PRILL-QERSHOR 2013

• NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

MUAJI	TM1-2013	TM2-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %	KOMENT
<i>Prodhimi m3</i>	3,676,805	3,985,192	308,387	8.39	
<i>Faturimi m3</i>	1,433,633	1,562,090	128,457	8.96	
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	2,243,172	2,423,102	179,930	8.02	
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	61.01	60.80	-0.21	-0.34	

KOMENTET:

Ne njisin punuse te Prizrenit ka pasur rritje te prodhimit ne tre mujorin e dyte te krahasuar me tre mujorin e pare per 8.39 % duke u bazuar ne shtimin e kapaciteteve te ujit tek 40 burimet.

Ne muajin Qershor kemi pasur renje te prodhimit me krahasim te nuajit Maj duke arsytuar te reshurat atmosferike, duke krijuar defekte dhe turbullira te ujit andaj kemi njoftuar qytetaret per mes mjeteve te informimit me kohe per mos perdorimin e ujit, si dhe kemi berë edhe pastrimin e rezervuarve.

RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE – JANAR-MARS – PRILL-QERSHOR 2013

NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË

MUAJI	TM1-2013	TM2-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %	KOMENT
<i>Prodhimi m3</i>	453,982	466,689	12,707	2.80	
<i>Faturimi m3</i>	188,692	200,193	11,501	6.10	
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	265,290	266,496	1,206	0.45	
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	58.44	57.10	-1.33	-2.28	

KOMENTET:

Ne njesin punuse Suharekë kemi pasur rritje te prodhimit krahasuar ne tremujorin e parë nga tre mujori i dytë për 2.80%. Pershkak te furnizimit jo te rregullt me uji nga “Pusi Atit” dhe defektet e paraqitura ne kete linje kemi pasur renje te prodhimit ne muajin Qershor.

RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE – JANAR-MARS – PRILL-QERSHOR 2013

• NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

MUAJI	TM1-2013	TM2-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %	KOMENT
<i>Prodhimi m3</i>	103,574	116,312	12,738	12.30	
<i>Faturimi m3</i>	53,204	58,238	5,034	9.46	
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	50,370	58,074	7,704	15.29	
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	48.63	49.93	1.30	2.67	

KOMENTET:

Ne njesin punuse Dragashi kemi pasur rritje te prodhimit te tre mujorit te dytë nga tre mujori i pare prej 12.30% , kurse per muajin Qershor kemi nje renje te prodhimit si arsyetim se fabrika e Ramateksit eshte ngarkuar me ujemates dhe ne bisedat e zhvilluar me perfaqesuesit e fabrikes eshte vendosur te vazhdohet perseri me tarifen fikse.

RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE – JANAR-MARS – PRILL-QERSHOR 2013

• NJËSIA PUNUES MALISHEVË

MUAJI	TM1-2013	TM2-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %	KOMENT
<i>Prodhimi m3</i>	323,040	293,212	-29,828	-9.23	
<i>Faturimi m3</i>	121,656	125,168	3,512	2.89	
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	201,384	168,044	(33,340)	-16.56	
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	62.34	57.31	-5.03	-8.07	

KOMENTET:

Ne njesin punuse ne Malishevë krahasuar me njesit tjera kemi pasur nje renje prej -9.23 %. Prej tre mujorit te dyte nga tre mujori i pare, sepse kemi pasur ekzekutime te punimeve ne stacioni e pompave ne Banje dhe nuk kemi bere furnizim te rregulltë nga ky stacion i pompave.

RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE – JANAR-MARS – PRILL-QERSHOR 2013

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN

MUAJI	TM1-2013	TM2-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %	KOMENT
<i>Prodhimi m3</i>	4,557,401	4,861,405	304,004	6.67	
<i>Prodhimi - l/sec</i>	586	618	32.2	5.50	
<i>Faturimi m3</i>	1,797,185	1,945,689	148,504	8.26	
<i>Faturimi l/sec</i>	231	247	16	7.07	
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	2,760,216	2,915,716	155,500	5.63	
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	60.57	59.98	-0.59	(0.97)	
<i>Uji I pafaturuar l/sec</i>	354.97	370.84	15.88	4.47	

KOMENTET:

Gjendja e furnizimit dhe prodhimit ne regjioni e Prizrenit ka ndryshim pozitiv ne TM-1 në TM-2 si ne furnizim dhe ne prodhim te ujit.

II. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË

2.1 Aktivitetet

- Në fund të këtij tremujorshi muaji në nivel rajonal janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 37.789 fatura, prej tyre: 32.705 amvisëri , 4.481 biznese dhe 603 institucione. Në këtë tremujor në krahasim me tremujorin paraprak kemi 402 fatura të lëshuara me tepër. Një pjesë nga kjo rritje e numrit të konsumatorëve është rezultat pasi në muajin qershor ka filluar të faturohen edhe fshati Kushnin i Hasit në njësin e Prizrenit dhe një pjesë e fshatit Mushtisht në njësin e Suarekës, pjesa tjetër është rezultat i pëlqimeve për kyqje të re dhe i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve ilegal nga ekipet e kontrollës dhe rezultat i pëlqimeve për kyqje në shërbim të ujësjellsit dhe kanalizimit.
Sipas njërive kemi këtë rritje të konsumatorëve në krahasim me TM1 :
Prizren: + 325, Suharekë: +604, Malishevë: + 38, Dragash: -3
- Gjatë muajit TM2 janë faturuar 1,945,689 m³ ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 1.563.262 m³, biznese: 139.574 m³ dhe institucione 245.853 m³ ujë. Nëse e krahasojm me tremujorin paraprak kemi një ne faturim më të madh prej 148.504 m³, ndërsa nëse krahasohet me TM2 të vitit paraprak kemi një rritje në faturim për 198.353 m³. Rritja e sasia së ujit të faturuar vjen si rezultat i rritjes së konsumit të tri kategorit e konsumatorëve, kjo rritje vjen edhe si rezultat i përmirimit të furnizimit me ujë.
- Arsyetim:
 - Rritja e faturimit për TM2 është rezultat i rritjes së konsumit në këtë periudhë në krahasim me periudhën paraprake si dhe shtimit të numrit të konsumatorëve nga muaji në muaj .
- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe ç'kyqjes në kuadër të KRU „Hidroregjioni Jugor“ sh.a., në bashkëpunim me udhëheqësit e njërive.

RAPORT I EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES - Prill-Qershor 2013

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyqjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
1	Prizren	296	24	23	2382	47,843.88 €
2	Suharekë	455	59	53	687	4,250.00 €
3	Malishevë	41	41	22	506	2,783.59 €
4	Dragash	7	0	0	0	0.00 €
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	799	124	98	3575	54,877.47 €

- Në nivel rajonal kemi pranë 535 ankesa të konsumatorëve prej tyre:
 1. 367 ankesa teknike- detektive, mungesë të ujit, rrjedhje të ujit
 2. 168 ankesa komerciale- ankesa rreth faturimit paushall të rritur, kontestim i faturave, faturim i dyfishtë etj
- Vazhdim i aksionit për njoftime për shkyçje të konsumatorët që:
 - Nuk i janë përgjigjur pagesave në dy muajt e fundit sidomos konsumatorët institucional dhe ka fillu riprogramimi i borgjit.
 - Kanë borxhe mbi 400 euro dhe nuk i përgjigjen pagesës dhe riprogramimit të borgjit. Janë ndërru terenet e inkasantëve në mënyrë që të përfshihen numër më i madh i konsumatorëve.
 - Kontrollë të konsumatorët rreth eliminimit të keqperdorimeve të ujit
- Pjesmarrje në takimet mujore në Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ku pjesmarrës në këto takime janë zyrtar nga ZRRUK dhe përfaqësues nga Kuvendet Komunale të zonës së operimit të KRU „Hidroregjioni Jugor“sh.a.
- Vizita në njësit operative me udhëheqësit e njësite lidhur me rritjen e efikasitetit rreth rritjes së faturimit, inkasimit dhe kontrollës të konsumatorët.

2.2 Pengesat në realizimin e objektivave

- Vështirësitë në inkasim si rezultat i mospagesës së obligimeve rrjedhëse për shërbimet e ujësjellsit :
 1. Te konsumatorët e amvisërisë- gjendja e rënde ekonomike
 2. Te bizneset – pamundësia e pagesave rrjedhëse e cila vjen nga rënia e punës në biznese.
 3. Te konsumatorët insticional –planifikimet e vogla në buxhet të organizatave buxhetore si dhe alokimet buxhetore në periudha tremujore po e pamundësojnë pagesën rrjedhëse për çdo muaj të kësaj kategori.
- Rritja e numrit të konsumatorëve si raste sociale si dhe rritja e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për të paguar obligimet ndaj kompanisë.
- Mosfurnizimi i rregullt me ujë në disa zona (reduktive) po ndikojnë në inkasim të shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit.

2.3 Planet në vazhdimësi

- Formimi i dy ekipeve për së bashku me operativen për shkyçjen e konsumatorve borgjlinj të mëtej mbi =400,00 E në muaj do të shkyqen 10-20 konsumator të cilët

nuk i përgjigjen pagesës, ky aktivitet do të zhvillohet me eskavator i cili do të aktivizohet 3 ditë brenda javës.

- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shuma të larta të borgjëve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për riprogramimin e borgjëve në mënyrë që këta konsumatorë të futen në sistemin të pagesave të fakturave
- Konsumatorët të cilët shkyqen nga rrjeti për mos pagesë nuk do të rikyqen pa i paguar së paku 30% të borgjit total .
- Marrja e masave ligjore sipas Zyres rregullative për shkyqjen e konsumatorve për mos pagesë.
- Rritja e efikasitetit të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyqjes.
- Padia e konsumatorve në gjykatë për mos pagesë.
- Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e borgjëve aty ku kanë vështirësi inkasantet.
- Angazhim i ekipes së kontrollës për 3-4 ditë në muja nga njësia e Prizernit nga njëra njësi në tjetrën.
- Njësia e Suharekës ka planifikuar që në marrjen e këtyre masave konkrete që në të ardhmen të arrijë përmisimin dhe rritjen e shkallës së inkasimit dhe të arrijë një shkallë mesatare mbi 70% me qka llogarisim që ta arrijmë mbulimin e shpenzimeve operative.
- Formimi i dy ekipeve të kontrolles për zbulimin e kyqjeve ilegale dhe prandalimin e e keqpërdorimit të ujit në periudhën në vazhdim me orar prej orës 06:00 deri 16:00 dhe prej orës 16:00 deri në orën 22:00 në të gjitha njësit operative.

2.4 Raport i mediave Prill-Qershor 2013

PRILL 2013

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	02.04.2013	www.rtklive.com	ARTIKULLI: MINISTRI BEQAJ VIZITOI KOMPANINË "HIDROREGJIONI JUGOR"
2	02.04.2013	TV-BESA TV-OPINION TV-PRIZRENI	VIZITA E MINISTRIT TË MZHE- BEQAJ NË KRU- HIDROREGJIONI JUGOR
3	03.04.2013	KOHA DITORE	ARTIKULLI: BEQAJ PRANON SE KËRKESAT E QYTETARËVE PËR SHËRBIME MË TË MIRA JANË LEGJITIME
4	03.04.2013	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: BEQAJ: ZËRAT PËR LARGIMIN TIM, SPEKULIME...
5	03.04.2013	MJETET E INFORMIMIT	NJOFTIM LIDHUR ME VENDIMIN PËR VENDOSJEN E UJËMATËSVE
6	04.04.2013	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: KËRKOHEN TË VENDOSJEN UJËMATËSIT
7	04.04.2013	GAZETA "TRIBUNA"	ARTIKULLI: S'KANË UJË PËR ORË TË TËRA
8	05.04.2013	ZËRI	ARTIKULLI: KONTROLLOHET UJI QË PINË PRIZRENASIT
9	17.04.2013	MJETET E INFORMIMIT	NJOFTIM: NDËRPRERJE E UJIT PËR SHKAK TË PUNIMEVE
10	18.04.2013	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: NDËRPRERJE TË UJIT PREJ ORËS 10:00 - 22:00
11	18.04.2013	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: SOT,DISA PJESË TË PRIZRENIT PA UJË
12	24.04.2013	MJETET E INFORMIMIT	NJOFTIM: PËR SHKAK TË PUNIMEVE, NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË RR. E MUHAXHERËVE
13	25.04.2013	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: RRUGA E MUHAXHERËVE NGA ORA 8 DERI NË 20 ME REDUKTIME TË UJIT

MAJ 2013

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	07.05.2013	www.prizrenpress.com	DYFISHOHEN KAPACITETET E UJËSJELLËSIT PËR MALISHEVËN ME RRETHINË
2	08.05.2013	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: MALISHEVA E ZGJIDH PROBLEMIN E UJIT
3	13.05.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: MUNGESË E UJIT NË DISA RRUGË PËR SHKAK TË DEFEKTIT
4	30.05.2013	TV OPINION	LAJME: SHPIMI I PUSIT NË SENIK-MALISHEVË
5	31.05.2013	www.tv-opinion.com	KËRKOHEN BURIME TË UJIT NË MRIZET E SENIKUT

QERSHOR 2013

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	07.06.2013	KOHA DITORE	ARTIKULLI: ZJARRI IA MERR JETËN ROJËS SË "HIDROREGJIONIT" NË SUHAREKË
2	07.06.2013	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: DIGJET NË VENDIN E PUNËS PUNËTORI I " HIDROREGJIONIT"
3	12.06.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: TURBULLIMI I UJIT, SI PASOJË E RESHJEVE TË SHIUT
4	14.06.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË, PËR SHKAK TË PASTRIMIT TË REZERVUARIT
5	18.06.2013	RTK	PËRURIMI I UJËSJELLËSIT NË BANJË-MALISHEVË
6	18.06.2013	KLAN KOSOVA	PËRURIMI I UJËSJELLËSIT NË BANJË-MALISHEVË
7	19.06.2013	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: INAUGUROHET UJËSJELLËSI NË BANJË- MALISHEVË
8	19.06.2013	KOHA DITORE	ARTIKULLI: DREJTORESHA E USAID-it KËRKON TË PAGUHEN FATURAT E UJIT
9	19.06.2013	LAJM	ARTIKULLI: PËRURIMI I UJËSJELLËSIT NË BANJË-MALISHEVË
10	19.06.2013	EPOKA E RE	ARTIKULLI: INAUGURIMI I UJËSJELLËSIT NË BANJË-MALISHEVË
11	20.06.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: MUNGESË E UJIT, SI PASOJË E MUNGESËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE TEK BUNAR 1
12	26.06.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË, PËR SHKAK TË PASTRIMIT TË REZERVUARIT DHE FILTRAVE

III. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

3.1 Aktivitetet

Departamenti i administrates gjatë këtij tremujori është marrur me përgaditjen e raportëve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgaditur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dalura nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për hulumtime dhe teknologji dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Janë vazhduar kontratat e punës që kanë qenë më kohëzgjatje prej tre(3) dhe gjatë (6) muajve ngase kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar në raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Janë përgaditur dhe shpallur në shtypinë ditorë 7 (shtatë) konkurse për vendet e parapara të punës nga Menaxhmenti i Kompanisë.
- Është bërë ndryshimi i koficientit të disa punonjësve pas kërkesës me shkrim nga udhëheqësit e tyre dhe aprovimit nga Zyrtari Kryesor financiar dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimin apo pelqimin nga udhëheqësit e tyre.
- Janë përgaditur fletëpalosjet e fushatës vetdisuese për masat ligjore të kodit penal, për keqpërdorimet e shërbimeve të ujësjellësve dhe janë shpërndarë konsumatorëve përmes inkasantëve.
- Në Kompani kanë bërë punë praktike profesionale student të Univerzitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit, Menaxhimit të burimeve njerzore, në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.
- Është përgaditur Marrëveshja e bashkëfinancimit ndërmjet palëve KRU”Hidroregjioni Jugor” dhe “Komuna e Suharekës” për projektin: Ndertimi I rezervarit me infrastrukturen përcjellëse në Sallagrazhdë.
- Është plotësuar formulari i kërkuar nga NJPMNP-MZHE me të dhënat e kërkuara operative dhe financiare për vitin 2011-2012 si dhe kompenzimet e Bordit sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Është përgaditur materiali sipas rendit të ditës për Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin që është mbajtur me 05.06.2013.
- Për Zyren e Auditorit të Përgjithshëm janë plotësuar dokumentet e kerkuara lidhur me sistemin e menagjimit të pagesave për çdo anëtar të Bordit për periudhen kohore 2009-2012.
- Në mbështetje të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Nenit 67 ,paragrafi 1.6, me Vendim i është nderprerë marrëdhënja e punës Asistentit administrativë të zyrës së teknologjisë informatike në njesinë e Prizrenit. Vendimi i marrë, është bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren me të cilin punëtori në fjalë(B. S) është shpallur fajtor me aplikimin e neneve 3,6,34,35,36,38,39,64,73 si dhe nenit 229 par 2 dhe 1 të KP të Kosovës dhe denuar me denim burgimi në kohëzgjatje prej 2(dy)vitesh.

- Pjesmarrja në Seminar pune organizuar nga SHUKOS me temë: Organizimi i Ndermarrjeve të ujit dhe kanalizimit dhe Zhvillimi i Resurseve Njerzore. Në këtë Seminar pune kanë qenë Pjesëmarrës nga secila KRU /Sekretarët dhe Zyrtarët për burime njerzore. Implementimi programit është ndarë në dy pjesë: PJESA I: Vlerësimi i Organizimit dhe ZhRNj për Ujësjetësit Publik dhe Pjesa II: Përgatitja e Modelit për Organizimin & ZhRNj të ndërmarrjeve të ujit dhe kanalizimit. Departamenti I Administrates ka pergaditur dhe paraqitur gjatë seminarit prezantim për Strukturën e Organizimit; kushtet ekzistuese , problemet e Organizimit dhe Menaxhimin e ZhRNj ne KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren.
- Vizitë nga Inspektoriat I Punes lidhur me rastin e vdekjs se dy punëtorëve të Kompanisë.
- Vizitë pune nga ish oficerët e lartën të KFOR-it Gjerman te bunari 1 dhe 2 dhe te zyret e vjetra të Kompanisë.

3.2 PERSONELI – PRILL– QERSHOR 2013

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Verejtje
Prill	282		2	0	17.04 vdekje e punt.XH.B
Maj	286	4		0	5 punt.pushim pa pagesë
Qershor	289	3		0	06.06.vdekje e punt.A.O 19.06.vdekje e punt.I.S

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - QERSHOR 2013

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	234	35	6	14	289
Numri i Punëtorëve në %	81.0	12.1	2.1	4.8	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	30	10.38	
MESHKUJ:	259	89.62	
TOTAL	289		

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: QESHOR 2013

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A						
KUALIFIKIMI						
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejë
Nr. i punëtorëve	26	16	187	55	5	289
Kualifikimi në %	9.00	5.54	64.71	19.03	1.73	

3.3 Raport rreth Punës së Zyrës Ligjore**RAPORTI I TREMUJORIT TË DYTË
GJYKATA THEMELORE DHE E APELIT**

Periudha raportues	Propozim për Ekzekutim	Seancat përgatitor	Seancat kryesore	Seancat e shtyra	Kallëzime penale	Përgjigje në Ankesa	TOTALI	Lëndë të ardhura nga Gjykata
PRILL 2013	3	/	5	1	/	3	12	23
MAJ 2013	/	2	2	2	1	2	9	14
QESHOR 2013	1	/	5	3	/	/	9	9
Totali	4	2	12	6	1	5	30	46

PËRGJIGJE NË ANKESA

Është dërguar në Gj. Themelore për Gjykatën e Apelit në Prishtinë një PËRGJIGJE NË ANKESË lidhur me Ankesën e bërë nga Debitori BESIM MUQAJ, Rr. Prevezës,nr. 38, Prizren, kundër AKTGJYKIMIT C.nr. 842/06, datë 20.02.2013, me të cilën është aprovuar Kërkesëpadia e Kompanisë sonë lidhur me pagesën e borxhit ndaj nesh nga Debitori.

Është dërguar në Gj. Themelore për Gjykatën e Apelit në Prishtinë një PËRGJIGJE NË ANKESË lidhur me Ankesën e bërë nga ish punëtori AHMET RAMA, Rr. Mbreti Agron,nr. 31, Prizren, Lëndën C.nr. 774/11, të protokolluar me Nr.pr. 394, datë 25.04.2013, lidhur me KONTEST NGA MERRËDHËNIA E PUNËS.

Është dërguar në Gj. Themelore për Gjykatën e Apelit në Prishtinë një PËRGJIGJE NË ANKESË lidhur me Ankesën e bërë nga ish punëtori REMZI HOXHA, nga Prizreni , Lëndën C.nr. 1214/12, të protokolluar me Nr.pr. 415, datë 30.04.2013, lidhur me KONTEST NGA MERRËDHËNIA E PUNËS.

Është dhënë PËRGJIGJE NË ANKESË, drejtuar Gjykatës së Apelit, kundër Ankesës së z. Feta Osmanolli.

Është dhënë PËRGJIGJE NË ANKESË, drejtuar Gjykatës së Apelit, kundër Ankesës së z. Imer Vorfaj.

KALLËZIM PENAL

Janë plotësuar të dhënat lidhur me Kallëzimit Penal të bërë nga viti 2012 dhe dërguar në Prokurorinë Themelore në Prizren kundër ish punonjësit Arsim Krasniqi të njesisë së Suharekës.

HEQJE DORË NGA KËRKESËPADIA

Nga Gjykata Themelore në Prizren kemi pranuar AKTGJYKIM NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESË PADIA lenda C.nr. 71/10, Paditësi KONTEST I PUNËS.

PAJTIM GJYQËSORË

Është arritur **PAJTIM GJYQËSORË** për Lëndën C.nr. 853/2008, rasti i kompensimit të dëmit për Naser, Nazmije dhe Erblin Sylaj, pajtimi konsiston në pagesën e dëmshpërblimit në lartësinë prej 2.251 E, të cilat janë paguar në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh.

PARASHTRESË

Është bërë PARASHTRESË PËR PËRJASHTIMIN E EKSPERTIT FINANCIAR z. HAMDË KASTRATI PËR KRYERJEN E EKSPERTIZËS FINANCIARE sipas kërkesës së AKTVENDIMIT C.nr. 603/09, të datës 22.03.2013. Kjo parashtresë është pranuar dhe është caktuar ekspert tjetër lidhur me kryerjen e ekspertizës.

Është perpiluar PËRGJIGJE NË KËRKESËN E AVOKATIT TË POPULLIT drejtuar BORDIT TË DREJTORVE të KRU-së lidhur me Ankesën e parashtruar nga z. Gëzim Doda për kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.

Është dërguar në Gj.Themelore një Parashtresë lidhur me lëndën PM.nr. 149/11, lidhur me Lëndën e ardhur gabimisht tek ne ngase e njëjta duhet ti drejtohet K.R.U. "RADONIQI"-Gjakovë.

PARASHTRESA LIDHUR ME ADRESAT E KONSUMATORËVE

PARASHTRESË LIDHUR ME ADRESËN e Konsumatorit Isa Osmankaj.

PARASHTRESË LIDHUR ME ADRESËN e Konsumatorit Haxhi Qerreti.

PARASHTRESË LIDHUR ME ADRESËN e Konsumatorit Aziz Bytyqi.

VENDIMET E MARRA NGA GJYKATA NË FAVOR TË KOMPANISË

1. Nga Gjykata Themelore në Prizren ka ardhur AKTGJYKIM ku Padia e paditësit AHMET RAMA me C.nr. 774/11, është aprovuar pjesëri-shtë, pra kërkohet vetëm pagesa e dyfishit të kohës së paraparë sipas Kontratës së punës.
2. AKTGJYKIM nga Gjykata Themelore me të cilin Konstatohet se është ZGJIDHUR NË FAVOR TË KOMPANISË Padia e Kompanisë sonë (C.nr.441/03) kundër të paditurit - Debitorit për Borxh në lartësi 449.76 Euro REGJEP SHAPELLI nga Prizreni.
3. AKTGJYKIM nga Gjykata Themelore me të cilin APROVOHET kërkesëpadia e Kompanisë sonë lidhur me PADINË mbi BORXHIN (278,24 €), e Debitorit Imer Vorfaj, nga F. Kobanjë, lidhur me Lëndën C.nr. 223/06, kështu që urdhërohet i Padituri që BORXHIN ta paguaj nga dita e pranimit të Aktgjykimit e në afat prej 15 ditësh.
4. AKTGJYKIM nga Gjykata Themelore lenda C.nr. 1214/12, me të cilin REFUZOHET PADIA E PADITËSIT REMZI HOXHA – KONTEST PUNE - SI E PABAZUAR, pra Gjykata Themelore e Prizrenit ka vendosur në favor të Kompanisë.
5. AKTGJYKIM nga Gjykata Themelore me të cilin APROVOHET kërkesëpadia e Kompanisë sonë lidhur me PADINË mbi BORXHIN (270,31 €), e Debitorit HIRA (SAIT SKENDERI), Rr. W. Volker, pn. Prizren, lidhur me Lëndën C.nr. 850/12, kështu që urdhërohet i Padituri që BORXHIN ta paguaj 7 ditë pas plotfuqishmërisë së vendimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.
6. Gjykata Themelore merr URDHËR PAGESË për lenden C.nr. 421/06 me të cilin Gjykata Themelore në Prizren E URDHËRONË Debitorin Muharrem Kastrati, Rr. Erhan Mazreku, nr.71, në Prizren, që në emër të borxhit në lartësi prej 398.53 Euro si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore ti paguaj në arkën e Paditësit në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së kësaj Urdhërpagese.
7. AKTGJYKIM nga Gjykata Themelore me të cilin APROVOHET kërkesëpadia e Kompanisë sonë lidhur me PADINË mbi BORXHIN (757.90 €), e Debitorit SADETE CURRI, nga Prizreni, lidhur me Lëndën C.nr. 408/06, kështu që urdhërohet e Paditura që BORXHIN ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.
8. AKTVENDIM nga Gjykata Themelore në lëndën C.nr. 603/09, Iljaz Buleci dhe të tjerët, me të cilin APROVOHET kërkesa e të Paditurës së dytë K.R.U."Hidroregjioni Jugorë"Sh.A.me seli në Prizren, për përjashtimin e ekspertit financiar Z. HAmidi Kastrati në kryerjen e ekspertizës financiare.
9. AKTGJYKIMIN nga Gjykata Themelore në Prizren lenda C.nr. 84/12, PJESËRISHTË APROVOHET kërkesëpadia e Kompanisë sonë lidhur me PADINË mbi BORXHIN (490.66 € - lejohet ekzekutimi i borxhit në lartësi prej 119.13 €, si dhe shpenzimet e taksës gjyqësore në lartësi prej 10 €), e Debitorit DASHNOR GËRMIZI.

10. AKTGJYKIMIN për lenden C.nr. 842/2006 nga Gjykata Themelore me të cilin nga Gjykata Themelore në Prizren është hedhur poshtë ANKESA e Debitorit BESIM MUQAJ si e PA AFATSHME për BORXHIN (1.202.00 € - ku detyrohet Debitori që borxhin ta paguaj sipas Aktgjykimit të shkallës së parë, pra në lartësinë e 1.202.00 €).
11. AKTGJYKIM sjellë nga Gjykata Themelore e Prizrenit lidhur me lëndën C.nr. 828/11, datë 13.02.2012, me të cilin paditësit MUSTAFA KAZAZI i është REFUZUAR KËRKESËPADIA lidhur me LIRIMIN NGA PAGESA E UJIT TË SHPENZUAR si dhe Kërkesës për MARRJEN E MASËS SË SIGURISË.
12. Nga Gj. Themelore në Prizren – DEGA MALISHEVË ka ardhur AKTGJYKIMIN C.nr. 125/08, datë 19.04.2013, me të cilin nga Gjykata Themelore në Prizren - DEGA MALISHEVË, është hedhur poshtë ANKESA e Debitorit IMER KRASNIQI nga MALISHEVA si dhe detyrohet i njëjti që Kompanisë “Hidroregjioni Jugorë” t`ia paguaj borxhin në shumën prej 335.92 €, si dhe 13.00 € shpenzimet procedurale.

VENDIMET GJYQËSORE KUNDËR KOMPANISË

AKTGJYKIMIN nga GJYKATA SUPREME E KOSOVËS Rev.nr. 248/2012, datë 17.05.2013, me të cilin nga kjo Gjykatë REVIZIONI I PARASHTRUAR nga Kompania kundër punonjësit Gëzim Doda, është HEDHUR POSHTË SI I PABAZUAR.

AKTVENDIM nga Gjykata Themelore e Prizrenit lenda C.nr. 782/05, sipas të cilit Padia e Kompanisë sonë konsiderohet e tërhequr nën arsyetimin se Paditësi (Kompania) nuk e ka siguruar adresën e saktë të të paditurit, gjë që ka ndodhur e kundërta por është në pyetje një lëshim nga ana e Gjykatës Themelore.

SHPALLET INKOMPETENTE GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AKTVENDIM nga Gjykata Themelore lenda C.nr. 246/10, me të cilin Gjykata Themelore në Prizren shpallet INKOMPETENTE në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje kontestimore, dhe se Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore ka kompetence që në shkallë të parë të gjykojë për kontestet ndërmjet personave juridik.

Masat e shqiptuara nga Gjykata për kundërvajtje në Prizren lidhur me Paditë e bëra nga KRU për kyqjen ilegale të konsumatorëve për periudhën kohore Prill – Qershor 2013

Gjatë periudhës kohore Prill – Qershor 2013, nga Gjykata për Kundërvajtje e Prizrenit janë shqyrtuar gjithsej 24 (njëzet e katër) Kërkesa për kyqje ilegale.

1. Nuk ka pasur të shqiptuar masa të qortimit;
2. Nga këto Kërkesa 4 (katër) kërkesa janë hedhur poshtë;
3. Për 5 (pesë) Kërkesa është shqiptuar masa e pezullimit;

4. Për 15 (pesëmbëdhjetë) Kërkesa është shqiptuar masa e dënimit në të holla, ku shuma totale e dënimeve e kap shifrën e 1160 (njëmijë e njëqindtë e gjashtëdhjetë) Euro.

Tremujori i II-të	Masa e qortimit	Hidhet poshtë	Masa e pezullimit	Masa e dënimit në Euro	Të kryera gjithsej	Shuma totale e dënimeve në E
Prill	0	4	2	2	8	200 €
Maj	0	0	1	5	6	410 €
Qershor	0	0	2	8	10	550 €
Totali	0	4	5	15	24	1160 €

Paraqitja tabelare e Vendimeve të lëshuara nga Ankesat e konsumatorëve

Muaji	Vendimet të lëshuara	Vërejtje
Prill-Qershor	98 Vendime	

3.4 Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative

Gjatë kësaj periudhe tremujore, puna e Asistentëve të IT pranë Kompanisë kryesisht identifikohet me këto aktivitete dhe veprimtari:

- Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.
- Përkujdesje për qasjen e kompanisë në rrjetin e internetit.
- Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror NAVISION, serverave të Njësive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.
- Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.
- Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të kompanisë
- Riparim harvderik dhe softverik të paisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.
- Mbikqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe servisimeve të paisjeve kompjuterike e paisjeve të ngjajshme teknike.
- Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.

Problemet

Janë përzgjedhur disa nga problemet më të hershme që na kanë përcjellur.

- Serveri që kemi në dispozicion (NAVISON SERVER), nuk është i përshtatshëm për kërkesat dhe nevojat e mëdha të kompanisë. Kam shumë ankesa nga klientët e qasjes në databazë.
- Rrjeti që kemi në dispozicion është një ndër rrjetet më të dobëta në qytet. Duke u bazuar në gjërësinë e brezit të rrjetit që paguhet për 12Mbps dhe vjen vetëm 4Mbps ndonjëherë edhe më poshtë.
- VPN Routeri nuk është i blerë dhe i vendosur tek koagolatorët. Një nevojë e kahershme, pas vendosjes së zyrës së pagesave në atë pikë.

Zgjidhjet

- Shtimi i RAM memorjeve nga 8GB në 16GB.
- Mundësia e blerjes së një serveri me fuqi më të madhe procesorike; Intel Xeon 2 x Quad Core.
- Rregullimi i menjëhershëm i brezit të rrjetit. Kompania IPKO jep rrjetin më të përshtatshëm për biznese. Rrjetin që e kemi ne, kompania në fjalë e jep nëpër shtëpi private. Neve na duhet 10Mbps Doënlload 10Mbps Upload.
- Blerja dhe konfigurimi i VPN Routerit tek koagolatorët.

Arësye e kësaj është se njësitë e kompanisë tonë kanë ankesa në qajse në server. Futja e një pagese duhet pritur një mesatare prej 4 minutash. Mos të flasim për shtypjen e faturave dhe shërbimeve të tjera.

IV. AKTIVITETI I SHËRBIMIT FINANCIAR

4.1 AKTIVITETET - PRILL-QERSHOR-2013

Shërbimi financiar, në tremujorin e dytë ka pas aktivitete të shumëta, më posht do t'i listojmë disa nga aktivitetet:

- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje,
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet;
- Rifreskimi i shënimeve; të pagueshmet dhe të arkëtueshmet
- Lisitimi i borxheve dhe pagesa e furnitorëve
- Prgatitja e raporteve mujore; faturimi, inkasimi dhe shpenzimet; ZRRUK, etj
- Takime me Kryeshëfin dhe Bordin për raportet tre mujore I, performancën etj.
- Raportet ditore me shërbimet brenda departamentit të financave si dhe brenda ndërmarrjes;

- Takim me zyrtarët e ATK-së në Prishtinë, lidhur me borgjin e akumuluar për vitet 2002, 2003, 2004 dhe 2005;
- Inkasimi në këtë tre mujor të dytë, në krahasim me tremujorin e parë 2013, është më i ulët. Sidomos në muajin e fundit të tre mujorit të dytë kemi pasur një ulje të inkasimit, në veqanti te kategoria e intitucioneve kemi pasur një rënje të dukshme, me gjithë angazhimin tonë. Me arsyen se nuk janë alokuar mjetet për institucionet për këtë periudhë. Pra, kjo ka ndikuar direkt në ulje të inkasimit edhe në këtë tre mujor.

4.2 RAPORTI I PERFORMANCES FINANCIARE JANAR-MARS – PRILL-QERSHOR 2013

• NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

MUAJI	TM1-2013	TM2-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %	KOMENT
<i>Faturimi nga uji €</i>	761,189.31 €	837,089.70 €	75,900.39 €	9.97	
<i>Faturimi- te tjera €</i>	10,540.00 €	39,932.47 €	29,392.47 €	278.87	
<i>Faturimi Total €</i>	771,729.31 €	877,022.17 €	105,292.86 €	13.64	
<i>Inkasimi nga uji €</i>	560,307.48 €	558,459.53 €	- 1,847.95 €	-0.33	
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	11,007.28 €	20,526.05 €	9,518.77 €	86.48	
<i>Inkasimi Total €</i>	571,314.76 €	578,985.58 €	7,670.82 €	1.34	
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	28700	29025	325	1.13	
% e inkasimit	73.61	66.71	-6.90	-9.37	
<i>Shpenzimet</i>	593,543.18 €	517,301.45 €	- 76,241.73 €	-12.85	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.96	1.12	0.16	16.28	

KOMENTET:

1. Faturimi nga uji është rrit në krahasim me tremujorin paraprak për arsye të rritjes së konsumit si dhe rritjes së numrit të konsumatorëve nga muaji në muaj. Faktor tjetër me rëndësi është marrja nën menaxhim të rrjetit të ujësjellsit të Lugishtës së Hasit dhe Kushninit të Hasit.
2. Faturimet tjera janë rezultat i taksave të për kyqje dhe të hyra tjera , tremujori I dytë ka një rritje të këtij faturimi pasi që ndërtimi i banesave kolektive dhe shtëpive individuale prejudikon edhe faturimet për taksat e kyqjes.

3. Te faturimi total kemi një rritje si rezultat I rritjes së dy treguesve të mëhershëm(faturimit nga uji dhe faturimit total).
4. Në tremujorin e dytë kemi një rënie të vogël nga inkasimi I ujit pasi që pagesat nga institucionet që janë prit të bëhen gjatë muajit qershor ato janë bërë pjesërisht ku ka ndiku që të bie inkasimi. Pritet që gjatë muajit korrik institucionet buxhetore të kenë alokime dhe të paguajn edhe për muajt paraprak.
5. Inkasimet tjera kane rrit inkasimin total , kështu që në total kemi rritje të inkasimit ne total.
6. Rritja e numrit të konsumatorëve vjen si rezultat I marrjes në menaxhim te fshatit Kushnin te Hasit ndërsa pjesa tjetër është rezultat I pëlqimeve dhe legalizimeve të konsumatorëve illegal.
7. Rënia e përqindjes së inkasimit është rezultat i rritjes së vlerës së faturuar andaj raporti në mes shumës së faturuar dhe shumës së inkasuar ka rezultu me rënie në përqindje.

RAPORTI I PERFORMANCES FINANCIARE – JANAR-MARS – PRILL-QERSHOR 2013

NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË

MUAJI	TM1-2013	TM2-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %	KOMENT
<i>Faturimi nga uji €</i>	104,518.18 €	110,249.81 €	5,731.63 €	5.48	
<i>Faturimi- te tjera €</i>	3,161.07 €	9,507.69 €	6,346.62 €	200.77	
<i>Faturimi Total €</i>	107,679.25 €	119,757.50 €	12,078.25 €	11.22	
<i>Inkasimi nga uji €</i>	50,645.39 €	48,746.40 €	- 1,898.99 €	-3.75	
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	3,675.93 €	9,531.10 €	5,855.17 €	159.28	
<i>Inkasimi Total €</i>	54,321.32 €	58,277.50 €	3,956.18 €	7.28	
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	3667	4271	604	16.47	
<i>% e inkasimit</i>	48.46	44.21	-4.24	-8.75	
<i>Shpenzimet</i>	73,398.30 €	69,094.03 €	- 4,304.27 €	-5.86	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.74	0.84	0.10	13.97	

KOMENTET:

1. Faturimi nga uji : kemi një rritje të faturimit në TM2 për 5.731,63 Euro në krahasim me TM1 arsya faturimi I fshatit Mushtisht dhe regjistrimi I konsumatorve të rinj mbrenda TM2
2. Faturime tjera: Gjithashtu kemi një rritje prej 6.346.62 Euro në TM2 në krahasim me TM1 arsya inkasimi I takses nga pelqimet për kyqje te konsumatoret e rinj dhe te fshati Mushtisht.
3. Inkasimi nga uji : kemi një rënje prej 1.898,99 Euro mospagesa e Institucioneve per munges buxheti sidemos në muajin Qershor.
4. Nr. Konsumatorëve: Kemi rritje per 604 konsumatorve arsya marrja në menagjim I fshatit mushtisht dhe regjistrimi I konsumatorve të rinj dh eregjistrimi I konsumatorve në Fshatin Gjinoc.
5. % e inkasimit :Kemi një renje për arsye se në muajin maj është faturuar fshati mushtisht kurse është inkasuar në Muajin qershor si dhe një gabim te llog.e faturimit nga ana e zyrtarit për raportim gabim teknik ka ndiku në uljen e % së inkasimit.
6. Shpenzimet: kemi një rënje në TM2 në krahasim me TM1 për 4304.27 arsya shpenzimet e rrymes elektrike në TM1 jan llogaritur me tarifen dimrore që jan bukur të larta (Vrejtje: në funksion jan mbi 25 pompa kapacitet prej 7 kw deri në 30kw.
7. Mbulimi operativ: Edhe përkundër rritjes së koeficientit të mbulimit operativ në TM2 shpenzimet e rrymes dhe shpenzimet fikse janw të mwdha.

RAPORTI I PERFORMANCES FINANCIARE – JANAR-MARS – PRILL-QERSHOR 2013

• NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

MUAJI	TM1-2013	TM2-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %	KOMENT
<i>Faturimi nga uji €</i>	34,701.08 €	38,384.62 €	3,683.54 €	10.62	
<i>Faturimi- te tjera €</i>	723.91 €	1,302.88 €	578.97 €	79.98	
<i>Faturimi Total €</i>	35,424.99 €	39,687.50 €	4,262.51 €	12.03	
<i>Inkasimi nga uji €</i>	25,257.55 €	29,872.23 €	4,614.68 €	18.27	
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	723.90 €	1,302.90 €	579.00 €	79.98	
<i>Inkasimi Total €</i>	25,981.45 €	31,175.13 €	5,193.68 €	19.99	
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	1086	1083	-3	-0.28	
<i>% e inkasimit</i>	72.79	77.82	5.04	6.92	
<i>Shpenzimet</i>	26,584.25 €	25,674.02 €	- 910.23 €	-3.42	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.98	1.21	0.24	24.24	

KOMENTET:

Faturimi nga tremujori i parë në të dytin ka pasur rritje sepse një pjesë e konsiderueshme e konsumatorëve që nuk jetojnë rregullisht në Dragash, kanë qenë për pushime si dhe ka pasur shfrytëzim më të madh të ujit në fabrikën “Remateks”.

Inkasimi gjatë gjithë periudhës gjashtëmujore ka qenë konstant, i qëndrueshëm dhe me tendencë rritje nga muaji në muaj.

Shpenzimet operative të njësisë janë minimale ndërsa shpenzimet nga të ardhurat personale janë rritur për shkak të pranimit të punëtorëve të ri.

Duke u bazuar në të dhënat tabelare të këtij raporti, shihet se ka rënje të numrit të konsumatorëve gjë që nuk është e saktë sepse të dhënat tabelare kanë rezultuar nga parregullsitë e shtypjes së faturave të dyfishta të cilat më pas janë përmirësuar.

RAPORTI I PERFORMANCES FINANCIARE – JANAR-MARS – PRILL-QERSHOR 2013

- NJËSIA PUNUES

MALISHEVË

MUAJI	TM1-2013	TM2-2013	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %	KOMENT
<i>Faturimi nga uji €</i>	73,046.56 €	75,192.73 €	2,146.17 €	2.94	
<i>Faturimi- te tjera €</i>	2,942.16 €	2,994.19 €	52.03 €	1.77	
<i>Faturimi Total €</i>	75,988.72 €	78,186.92 €	2,198.20 €	2.89	
<i>Inkasimi nga uji €</i>	49,906.16 €	49,620.79 €	285.37 €	-0.57	
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	3,263.14 €	3,201.93 €	61.21 €	-1.88	
<i>Inkasimi Total €</i>	53,169.30 €	52,822.72 €	346.58 €	-0.65	
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	3372	3410	38	1.13	
<i>% e inkasimit</i>	68.32	65.99	-2.33	-3.41	
<i>Shpenzimet</i>	62,959.59 €	54,564.10 €	8,395.49 €	-13.33	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.84	0.97	0.12	14.63	

KOMENTET:

Pra siq tregon tabela me larte ne periudhen tremujore Prill-Qershor/2013 kemi performance jo te kenaqshme me mbulim operativ 0.98.

Shpresojme qe ne periudhen e ardheshme tremujore do te kemi mbulim operativ per njesine e Malisheves –kete per shkak te marrjes se masave te nevojshme qe do ti pershkruaj me poshte.

Nga data 20 qershor 2013 kame bere nderrimin e ekipes se kontrolles ku tani kame emëruar tre punëtorë tjerë dhe vetem ne javen e fundit te muajit qershor ka arrite te inkasoj 1197.43 €.shume kjo te cilen ekipa paraprake e kontrolles nuk ka arrite ta realizoj as per nje muaj.Hapi tjetër qe planifikoj te marre si pergjegjes i Njesise ne Malisheve eshte nderrimi i tereneve per tre inkasant me performance me te ulet.Ky hap eshte planifikuar me qellim te shterrjes se te gjitha mundesive para se te mirret ndonje mase perjashtuese te punetoreve me performance te dobet nga puna.

Nder shkaqet tjera qe po e rendojne gjendjen financiare te njesise ne Malisheve jane edhe mospagesa me rregull e faturave nga ana e institucioneve,pastaj aktivite te shumta te realizuara nga njesia rreth hulumtimeve te burimeve te ujit ne fshatin Senik ku kemi bere shpimin e pese (5) puseve dhe kemi gjetur mbi 100 l/s.Ne keto hulumtime ne kemi angazhuar nga tre punetor çdo dite dhe kjo ka ndikuar ne mos permbushjes se inkasimit Pastaj ,ritja e shpenzimeve te energjise elektrike si rezultat i shtimit te stacioneve pompuese gjithashtu po ndikon ne performance te njesise.

Aktivitetet që duhet shtuar për të qenë Njësi operuese e suksesshme janë:

- 1.Rritja e bashkepunimit me Komunat –nenshkrimi i memorandumeve te bashkepunimit
- 2.Paisja me ujemates e te gjithë konsumatoreve
- 3.Leximi i sakt i ujematesave
- 4.Dergimi me kohe i Njoftimeve per shkyqje
- 5.Shperndarja me kohe e faturave
- 6.Kontrolle rigoroze per te gjithë konsumatoret
- 7.Evitimi i shpejt i defekteve ne rrjet
- 8.Zbulimi i kyqjeve ilegale dhe keqperdoruesve te ujit
- 9.Shkyqja e te gjithë konsumatoreve me borgj mbi 500 €
- 10.Degimi i sa me shume lendeve ne gjykata dhe prioritetizimi i tyre
- 11.Largimi nga puna i punetoreve me performance te dobet,
- 12.Insistimi ne uljen e çmimit te energjise elektrike nga zrre-ja
- 13.Rastet sociale duhet ti marre Qeveria.

V. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM

Raporti në vijim paraqet një përmbledhje të aktiviteteve të ndërmarra të auditorit të brendshëm, për periudhën kohore janar – qershor 2013. Edhe pse për të gjitha aktivitetet e ndërmarra, detajisht është raportuar në takimet e komisionit të auditimit dhe ekzistojnë raporte të përgaditura me shkrim, mirëpo ky raport shkurtimisht paraqet një kronologji të aktiviteteve të ndërmarra.

-Fillimisht, gjatë kësaj periudhe është përgatitur raporti vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin 2012, ku janë paraqitur të gjitha auditimet e realizuara gjatë vitit të kaluar. Në raport, në formë të përgjithësuar, janë prezentuar rekomandimet e dhëna si dhe shkalla e implementimit të tyre.

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, është përgatitur dhe është aprovuar nga komisioni i auditimit:

- plani strategjik i punës së auditorit të brendshëm për periudhën 2013-2015 dhe
- plani vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin 2013.

Në pajtim me planin vjetor të paraparë, janë bërë auditime në disa subjekte audituese, sikurse në: departamentin e financave, departamentin teknik dhe në Njësinë Punuese të Suharekës. Fusha e auditimit ka qenë:

- menaxhimi i pasurisë,
- menaxhimi i llogarive të arkëtueshme – borxheve të kqija,
- menaxhimin i procesit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar,
- Menaxhimi i procesit të përlogaritjes së pagave,
- Menaxhimi i procesit të riparimit dhe vendosjes së ujëmatësve,
- Menaxhimi i proceseve dhe aktiviteteve të zhvilluara në Njësinë Punuese në Suharekë.

Pas përfundimit të auditimeve dhe testimeve të nevojshme, në pajtim me procedurat punës së auditimit është bërë:

- përgatitja e draftraporteve për të gjitha auditimet e lartpërmendura,
- mbajtja e takimeve me subjektet e audituara dhe diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe
- finalizimi i draftraporteve (përveq draft raportit të auditimeve të kryera në departamentin teknik dhe atë të Njësisë së Suharekës).

Gjatë kësaj periudhe, përpos aktiviteteve të lartpërmendura si dhe aktiviteteve të cilat janë të karakterit të përgjithshëm menaxherial, kam qenë i angazhuar në disa aktivitete tjera, ku si më kryesoret janë: përmendisikurse:

- Asistimi i rregullt me ekipin e auditorëve të jashtëm, të cilët kanë kryer auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2012.
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për rezultatet e implemetimit të rekomandimeve të Zyres së Auditorit të Përgjithshëm, lidhur me auditimin e efikasitetit menaxherial të kompanisë për vitin 2011,
- Poashtu kam marrë pjesë në disa takime pune në Prishtinë, sikurse në Zyren Rregullative (ZRRUK), në Administratën Tatimore të Kosovës dhe NJPMNP, si dhe
- Pjesëmarrjen në trajnimin e mbajtur për auditorët e brendshëm të organizuar nga NJPMNP - MZHE.

VI. RAPORT I AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT

Procedurat e prokurimit me vlera të mesme

Nr Rendor	Titulli I Kontrates	Nr. Prokurimit	Qmimi i kontrates	Emri I OE
1	Ritenderim:Furnizim me Karburante	Hj/13/001/1.2.1	86,650.00€	<i>n.p.t"lbrahimi" Shtime</i>
2	Shpimi I Pusit	HJ/13/002/2.3.6	8,510.00€	<i>n.sh "Geo Consulting"</i>
3	Furnizim me Pompa të ujit	HJ/13/003/1.3.6	8,565.00€	<i>Tafaj&Co</i>
4	Rehabilitimi I Rrjetit të ujësjellësit	HJ/13/004/5.2.1	117,836.00€	<i>(OE Lider) sh.p.k"Capital Group"</i>
5	Furnizim me rroba pune	HJ/13/005/1.3.6	7,225.00€	<i>n.p.t"Printeks"</i>
6	Hulumtimi I Burimeve te reje	HJ/13/006/5.2.1	E Anuluar	
7	Furnizim me Tonera	Hj/13/007/1.3.6	9,750.00€	<i>"Media Market" sh.p.k</i>
8	Sherbim me Eskavator	HJ/13/008/1.2.1	123,500.00€	<i>n.n."Ramiz Shehu"</i>

9	Ritenderim: Furnizim me Beton	HJ/13/009/1.2.1	Ne Procedur	
10	Sherbim:Punimi I projekteve per ndertimin e Pendes Akumuluese dhe Hulumtimi I ujrave nentoksore	HJ/13/010/2.3.6	9,800.00€	<i>n.sh"Geo Consulting"</i>
11	Ritenderim:Hulumtimi I Burimeve të reja	HJ/13/006/5.2.1	74,015.00€	<i>n.sh.n"Burimi"</i>
12	Furnizim me Material Elektrikë	HJ/13/011/1.3.6	9,493.50€	<i>n.t.sh"Kastel-Ing"</i>
13	Furnizim me mobilje per Objektin e ri ne Malisheve	HJ/13/012/1.3.6	8,850.00€	<i>"Graniti"sh.p.k</i>
14	Ndertimi I Rezervoarve ne Grejkoçë-Suharekë	HJ/13/013/5.1.1	Në procedurë	
15	Ndertimi I Galerisë për nënkalim te 40-Burimet	HJ/13/014/5.3.6	8,884.00€	<i>n.p.t"Sharri Beton"</i>
16	Furnizim me pjesë të ujësjellësi	HJ/13/015/1.3.6	4,304.80€	<i>d.p.t"Endriti"</i>
17	Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellësit ,Faza II-Hapja e Pusit	HJ/13/016/5.3.6	6,325.00€	<i>n.sh.n"Burimi"</i>
18	Furnizim me Pjese Fazonike	HJ/13/017/1.3.6	4,703.00€	<i>n.p.t"Xerxa"</i>

Procedurat e prokurimit me vlera te vogla

Nr Rendor	Titulli I Kontrates	Nr. Prokurimit	Qmimi i kontrates	Emri I OE
1	Furnizim me Trafo	HJ/13/001/1.4.7	960.00€	“OK”sh.p.k
2	Furnizim me rroba për puntorë	Hj/13/002/1.4.7	980.00€	d.p.t”Smart Men”
3	Furnizim me material ndertimor	HJ/13/003/1.4.7	627.00€	“OK”sh.p.k
4	Furnizim me material ndertimor per renovimin e zyreve ne objekin e vjeter	HJ/13/004/1.4.7	760.00€	“OK”sh.p.k
5	Sherbim:Pastrimi I Ambientit te 40-Burimet	HJ/13/005/2.4.7	952.00€	n.sh”Vëllezërit J&D”
6	Sherbim :Furnizim me Goma të Automjeteve	HJ/13/006/1.4.7	864.00€	n.t.p”Feroda”
7	Furnizim me Karriga per zyren e Faturimit	HJ/13/007/1.4.7	620.00€	Fleksit
8	Furnizim me Gyp dhe Llamarinë	HJ/13/008/1.4.7	950.00€	Afa-Com

9	Furnizim me material Elektrikë	HJ/13/009/1.4.7	581.20€	n.t.p"Neon"
10	E Anukuar	HJ/13/010/1.4.7		
11	Furnizim me material të ujësjetës -Bazhdarim	HJ/13/011/1.4.7	955.85€	n.p"KWE"
12	Furnizim me kompjuter te perdorur	HJ/13/012/1.4.7	480.00	n.t.sh"SIB-IT"
13	Furnizim me material ndertimor per Banjo	HJ/13/013/1.4.7	668.95€	"Dardania Commerce"
14	Sherbim :Dezinfektimi I Objektit te KRU-së	HJ/13/014/2.4.7	850.00€	Imago

STRUKTURA ORGANIZATIVE
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN

